


# AKK

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është themeluar në Kuvendin themelues me **30 qershor 2001**, pas zgjedhjeve të para demokratike komunale në Kosovën e pasluftës. Anëtarë të Asociacionit janë Komunitetet e Kosovës. Themelimi i AKK-së është mbështetur në **nenin 10 të Kartës Evropiane të Autonomisë Lokale në kuadër të Këshillit të Evropës** (e drejta për asociacion). AKK-ja sheh nevojën për të qartësuar kompetencat në fusha të ndryshme dhe të forcoj marrëdhëniet mes nivelit lokal dhe atij qendror.

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Evropës, është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore) dhe anëtar vëzhgues në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR)

[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

# Buletini

Viti III, Nr. 14

Janar 2006

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

### TELEGRAM NGUSHËLLIMI



**Presidenti i Kosovës  
Dr.Ibrahim Rugova  
1944 - 2006**

Me rastin e ndarjes nga jeta të Presidentit të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Ismet Beqiri ka lëshuar një telegram ngushëllimi drejtuar Familjes Rugova, Kryesisë së LDK-së dhe Popullit të Kosovës: Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Komunitetet e Kosovës me dhembje të madhe morën lajmin për ndarjen nga jeta të Presidentit të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova. Në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në emër të Komunave të Kosovës dhe në emrin tim personal ngushëllimet me të thella u shprehim Familjes Rugova, Kryesisë së LDK-së dhe mbarë popullit të Kosovës. Pushteti Lokal i Kosovës shprehet i vendosur në ndjekjen e rrugës së palëkundshme të Presidentit Rugova për Pavarësinë e Kosovës. Presidenti Rugova për ne si edhe për popullin e Kosovës njihet si artikulesi dhe arkitekti i projektit të Kosovës dhe popullit të tij për Pavarësi dhe Shtet Sovran të Kosovës. Ndarja nga jeta e Presidentit Rugova në kohën kur pritej të realizohej Pavarësia e Kosovës është humbje e madhe për Kosovën, mirëpo duhet të gjejmë forcë, që duke çmuar veprën e tij të tejkalojmë këtë dhembje të madhe në mënyrë që së bashku të dërgojmë në vend idenë dhe projektin e Presidentit Rugova për Pavarësinë e vendit tonë, Kosovës së tij të dashur. Zoti e bekoftë Presidentin tonë Dr.Ibrahim Rugova.

**Ismet Beqiri  
Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës**

## Nisi projekti "Trajnimi i anëtarëve të rinj të Kuvendeve Komunale pas zgjedhjeve lokale të viti 2006"

Me takimin me këshilltarët komunalë të Prishtinës dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që bëjnë monitorimin e punës së KK në Prishtinë filloi realizimi praktik i projektit të AKK-së "Trajnimi i anëtarëve të rinj të Kuvendeve Komunale pas zgjedhjeve lokale të viti 2006" i cili ka mbështetjen e Asociacionit të Komunave të Norvegjisë.

## U mbajt takimi i Bordit të AKK-së

Prishtinë, 17 janar 2006

Sot në lokalet e AKK-së u mbajt takimi i parë i Bordit të AKK-së për vitin 2006 dhe në përbërje të re të cilën e kryesoi kryetari z.Ismet Beqiri e ku ishin të pranishëm z.Ramadan Gashi nënkryetar i AKK-së dhe anëtarët e Bordit të AKK-së z.Fadil Ferati, z.Shaip Surdulli dhe z.Fatmir Rashiti. - fq.3

## **Nisi projekti "Trajnimi i anëtarëve të rinj të Kuvendeve Komunale pas zgjedhjeve lokale të viti 2006"**

**Me takimin me këshilltarët komunalë të Prishtinës dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që bëjnë monitorimin e punës së KK-së në Prishtinë filloi realizimi i projektit të AKK-së "Trajnimi i anëtarëve të rinj të Kuvendeve Komunale pas zgjedhjeve lokale të viti 2006" i cili ka mbështetjen e Asociacionit të Komunave të Norvegjisë.**

Takimin e ka hapur kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe njëherit kryetar i Komunës së Prishtinës z.Ismet Beqiri i në emër të këtyre dy institucioneve që ai drejton u dëshiroj mirëseardhje të pranishmëve. Kam kënaqësinë që në emër të AKK të ju dëshiroj mirëseardhje në fillimin e implementimit të projektit mbi "Trajnimin e antarëve të rinj të Kuvendeve Komunale në Kosovë pas zgjedhjeve lokale të vitit 2006". Ky projekt realizohet me përkrahje financiare të Asociacionit të Komunave nga Norvegjia dhe do të implementohet vetëm për antarët e rinj të KK-ve. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z.Lufti Haziri duke marrë pjesë në fillimin e implmentimit të këtij projekti në fjalën e tij ndër të tjera theksoi se jam i nderuar që jam këtu me ju në kuadër të fillimit të këtij projekti për nevojat e trajnimit për këshilltarët e ardhshëm komunalë. Mbështetja e këtij projekti nga Asociacioni i Komunave të Norvegjisëdo të thotë shumë jo vetëm si mbështetje e thjeshtë por si njëri ndër miqtë e AKK-së dhe kështu le prapa shumë projekte e trajnime që kanë pretenduar të japin ndihmesën në trajnimet për këshilltarët komunalë të Komunave të Kosovës. Jemi në këtë stad ku duam të marrim gjitha nevojat dhe të bëjmë identifikimin e tyre për këshilltarët e ardhshëm. MAPL-ja dhe OSBE-ja janë duke punuar për zgjedhjet e ardhshme lokale dhe po punojmë që të organizojmë zgjedhjet të drejtëpërdrejta për kryetarët e komunave dhe shpresojmë se deri në mars do të përfundojmë këtë dilemë.

Komunat e Kosovës pas zgjedhjeve të ardhshme do të duken ndryshe si në numër ashtu edhe sa i përket dokumenteve rregullative. Për këtë duhet të përgatiten këshilltarët komunalë që të ushtrojnë rolin e tyre karshi detyrave dhe përgjegjësiive. Komuna e Prishtinës në kuadër të organizimit



**Prishtinë, 16 janar 2006**



**Prishtinë, 16 janar 2006**



**Skenderaj, 18 janar 2006**



**Skenderaj, 18 janar 2006**

të ardhshëm të pushtetit lokal do të ketë një status të ri e të ndryshëm nga komunat tjera meqë kjo për kryeqytetet është e regulluar në formë të veçantë edhe në shtetet tjera. Në fund dua të shtoj se sa i përket këtij projekti që ne sot po fillojmë implementimin etij dua të theksoj se përfituesit kryesor do të jenë këshilltarët komunalë të Komunave të Kosovës. Ky projekt do të realizohet vetëm për antarët e rinj të KK-ve të cilët do të fillojnë punën pas zgjedhjeve të ardhshme komunale. Projekti në fjalë përban tri komponente.

Komponenta e I-rë: Së pari do të bëhet vlerësimi i nevojave për trajnim. Si do të bëhet kjo? AKK-ja do të organizojmë 15 takime pune me disa nga antarët e KK-ve dhe me OJQ-të lokale të cilat meren me monitorimin e punës së KK-ve. Pra, në një takim të jenë së bashku përfaqësuesit e KK-ve nga dy komuna si dhe OJQ-të nga dy komuna. Nga këto takime do të dilet me një raport se në çfarë teme antarët e rinj të KK-ve pas zgjedhjeve Lokale të vitit 2006 do të trajnohen.

Komponenta e II-të: Do të trajnohen trajnerët lokal. Nga secila komunë do të gjindet një anëtarë i KK-së i cili ka eksperiencë në punën e KK-ve. Këta persona do të trajnohen nga ekspertët lokal në temat të cilat do të identifikohen nga komponenta e I-rë Komponenta e III-të: Implemetimi i trajnimeve në të gjitha komunat e Kosovës pas zgjedhjeve lokale të vitit 2006. Këto trajnime do të implemetohen nga personat të cilët do të marrin pjesë në komponentët e II-të.

Takimet me këshilltarë komunal dhe me OJQ-të që bëjnë monitorimin e seancave të KK-ve ka vazhduar duke mbajtur takim në Skenderaj me komunat e Skenderajit dhe të Drenasit. Ndërsa dy takimet tjera të ardhshme u anuluan për shkak të vdekjes së Presidentit të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova ndërsa do të mbahen në ndërkohë.

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS****TELEGRAM NGUSHËLLIMI**

**Për: Ileshkinë e Kosovës dhe Familjen Sopi**  
Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Ismet Beqiri me rastin e vdekjes së papritur të Imzot Mark Sopit - Ileshkinë e Kosovës së Kosovës me anë të një telegrami ka ngushëlluar Ileshkinë e Kosovës dhe Familjen Sopi. Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Komunitet të Kosovës me dhembje të thellë morrën lajmin për vdekjen e papritur të Imzot Mark Sopit - Ileshkinë e Kosovës. "Vdekja e Imzot Mark Sopit është humbje e madhe për Kosovën kur kujtojmë se Imzot Sopi ishte një burrë i ndritur i Kosovës, një njeri me virtyte të larta njerëzore, kombëtare dhe institucionale dhe veçmas vlerësojmë lartë kontributin e Imzot Sopit për Pavarësinë e Kosovës.

E nderuara Ileshkinë e Kosovës, e nderuara Familje Sopi edhe në këto momente të rënda, duhet të gjeni forcë të përballonit humbjen e prijësit dhe më të dashurit Tuaj. Ne Jemi me JU".

*Telegrami është nënshkruar nga kryetari z. Ismet Beqiri*

**ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS****TELEGRAM NGUSHËLLIMI**

**Për: Komandantin e KFOR-it gjeneral lejtnat Xhuzepe Valot dhe Komandantin e Kontigjentit Sllovak të KFOR-it Lubos Balucha**

Në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në emër të Komunave të Kosovës dhe në emrin tim personal Ju shpreh ngushëllimet tona me rastin e aksidentit ku humbën jetën 42 ushtarë sllovak që kanë shërbyer në Kosovë në kuadër të misionit të KFOR-it në Kosovë. Humbja e jetës së ushtarëve që shërbyen në Kosovë është shumë e rëndë dhe pushteti lokal i Kosovës e përjetoi me shumë pikëllim këtë rast tragjik. Shërbimi i tyre ushtarak në kuadër të KFOR-it në Kosovë për një kohë të gjatë ishte shembullor dhe shumë njerëzor meqë ata ishin në shërbim të sigurisë dhe paqes në vendin tonë. Ju lutemi zoti Komandant Balucha, u'a përcjellin ngushëllimet tona edhe familjarëve të ushtarëve dhe mbarë shteti të Sllovakisë.

*Telegrami është nënshkruar nga kryetari z. Ismet Beqiri*

**Shoqata e Bashkive të Shqipërisë ngushëllon AKK-në**

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë me rastin e ndarjes nga jeta të Presidentit të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, me anë të një telegrami dërguar në Asociacionin e Komunave të Kosovës ka ngushëlluar Familjen Rugova, Pushtetin Lokal të Kosovës dhe mbarë popullin e Kosovës.



**I nderuari z. Kryetar Ismet Beqiri**

Në emër të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, Ju lutem pranonim ngushëllimet tona më të sinqerta për humbjen e Presidentit të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova. Po të kemi parasysh që kjo është një humbje që ka ardhur në Kosovë në ditët e saj të vështira, që kjo është një humbje që ka ardhur atëherë kur pritet të kurorëzohet pavarësia e Kosovës, që Kosova humbi misionarin e madh të paqes të lirisë dhe të dinjitetit njerëzor, që Kosova ka humbur një njeri i cili ishte një burrë i madh shteti megjithëse akoma Kosova nuk kishte një shtet të vetin atëherë dhembja është edhe më e rëndë. Për të gjithë kontributin e tij në gati dy dekada, ai mbetet lideri i pasfidueshëm i Kosovës.

Nëpërmjet jush i shprehim ngushëllimet tona familjes së Presidentit Rugova, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe të gjithë popullit të Kosovës.

**Shoqata e Bashkive të Shqipërisë**

**Komunitet e Maqedonisë ngushëllon AKK-në**

Asociacionin e Komunave të Kosovës me rastin e ndarjes nga jeta të Presidentit të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova e ka ngushëlluar edhe Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë.

"Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë BNJVL (ZELS) shpreh ngushëllimet më të thella dhe të sinqerta me rastin e vdekjes së Kryetarit Tuaj Dr. Ibrahim Rugova. Shpresojmë se ngushëllimin do t'a gjeni në veprat madhështore dhe humane që la për Ju dhe Kosovën".

**Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë**

**U mbajt takimi i Bordit të AKK-së**

Prishtinë, 17 janar 2006

Sot në lokalet e AKK-së u mbajt takimi i parë i Bordit të AKK-së për vitin 2006 dhe në përbërje të re të cilën e kryesoi kryetari z. Ismet Beqiri. Në këtë takim lu ishin të pranishëm z. Ramadan Gashi nënkryetar i AKK-së dhe z. Fadil Ferati - anëtar i Bordit të AKK-së, z. Shaip Surdulli - anëtar i Bordit të AKK-së dhe z. Fatmir Rashiti - anëtar i Bordit të AKK-së u diskutuan problemet me të cilat aktualisht ballafaqohet pushteti lokal në Kosovë dhe roli i Komunave të Kosovës në këtë fazë nëpër të cilën po kalon Kosova. Në këtë takim u miratua Plani i Punës së AKK-së për vitin 2006 si dhe projekte që priten të realizohen gjatë këtij viti nga ana e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Bordi i AKK-së në parim aprovoi idenë e kontakteve më të shpeshta me përfaqësuesit e institucioneve qendrore të Kosovës në rradhë të parë me ministrinë e Qeverisë së Kosovës për të debatuar shumë çështje që ndërlidhen mes pushtetit lokal dhe atij qendror në Kosovë. Poashtu anëtarët e Bordit të AKK-së diskutuan edhe për çështjet financiare dhe pagesat nga ana e Komunave të Kosovës, ku u tha njëzëri se duhet të itensifikohet puna e kryerjes së obligimeve financiare nga ana e Komunave për Asociacionin e Komunave të Kosovës. Poashtu në mbledhjen e Bordit të AKK-së u kërkua një dinamizim më i madh i anëtarëve të Bordit dhe kryetarëve të Komunave të Kosovës në punën rreth AKK-së si dhe u vendos që takimet e Bordit të AKK-së të jenë mujore.

ASOCIACIONI I  
KOMUNAVE TË  
KOSOVËS

**BULETINI**

Viti III, Nr. 14  
Janar 2005

**E përgatiti:**

**Arsim Osmani**  
Menaxher për Komunikim

Tel: 038/ 245-734;

Fax: 038 / 245-733

info@komunat-ks.net

www.komunat-ks.net



## Nëpër Komunitat e Kosovës janë mbajtur Mbledhje Komemorativë dhe janë hapur Librat e Zisë

### MAPL udhëzoi pushtetet lokale për ceremoninë e varrimit të Presidentit Rugova

Prishtinë, 22 janar - Me rastin e vdekjes së Presidentit të Kosovës dr.Ibrahim Rugova, në kuadrin e kompetencave të veta për koordinimin e punës me komunitat e Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka lëshuar udhëzimin administrativ për udhëheqjet komunale ku kërkohej që udhëheqjet komunale të marrin një sërë veprimesh për të siguruar funksionimin normal të institucioneve komunale dhe për të ofruar shërbime cilësore dhe me kohë për qytetarët e Kosovës dhe delegacionet e huaja që do të vijnë në Kosovë në rastin e organizimit të ceremonisë së varrimit.

Me rastin e ndarjes nga jeta të Presidentit të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova, Komunitat e Kosovës kanë mbajtur mbledhje komemorativë ku kanë nderuar veprën dhe jetën e Presidentit Rugova. Poashtu në të gjitha komunitat e Kosovës janë hapur librat e Zisë ku qytetarët janë nënshkruar duke nderuar jetën dhe veprën e lavdishme të Presidentit të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova. Po japim thekse nga mbledhjet komemorativë në disa komuna, zëdhënësit e të cilave i kanë dërguar materialet për Buletinin e AKK-së. "Presidenti Rugova ishte një

dhe Kosova nuk do të lindë asnjë si ai, është mesazhi i dhembje i kryetarit të Prishtinës Ismet Beqiri, për vdekjen e Presidentit Rugova. "Kryetari Rugova ishte ndër personalitetet e para, i cili përkrah liderëve tjerë evropianë, guximshëm ia ktheu shpinën kampit komunist dhe u bë prijës i popujve të tyre me vështrim drejt lirisë, demokracisë dhe botës së qytetëruar", tha kryetari i KK të Prishtinës z.Ismet Beqiri në mbledhjen komemorativë.

"Kryetari Rugova është një dhe i papërsëritshëm", tha ai. Ndërsa në mbledhjen komemorativë të komunës së Istogut, kryetari z.Fadil



Ferati tha se Presidenti Dr.Ibrahim Rugova, jo vetëm që ishte lider yni politik por ishte edhe lider shpirtëror i shqiptarëve të Kosovës, ishte shtylla ku populli i Kosovës mbështetej dhe besonte fuqishëm në vizionin e Dr. Rugovës. Presidenti Rugova, vuri themelet e para të shtetësisë së Kosovës, mbajti gjallë frymën e demokracisë në momentet më të vështira që pati populli ynë, vetëm me mënçurinë, urtësinë dhe vizionin e tij prej largpamësi, i hapi rrugën Kosovës drejt integriteteve euroatlantike.

Në historinë gjithkombëtare dhe europiane solli një frymë të re të letrave shqipe, duke hapur rrugën e njohjes

së historisë dhe kulturës shqiptare.Me identitetin e tij që krijoi në këto hapsira, duke shfrytëzuar gjithë potencialin e tij human, diplomatik e filozofik, gjeti formën dhe mënyrën më të mirë të depërtimit në diplomacitë e huaja. Formoi Lidhjen Demokratike të Kosovës, e cila u bë Lëvizje gjithëkombëtare dhe mblodhi në gjirin e saj mbi 99% të shqiptarëve anëkend botës, bashkim ky i paparë ndonjëherë në historitë e popujve të botës.

Në mbledhjen komemorativë në KK të Mitrovicës kryetari z.Mursel Ibrahimitha se Presidenti Dr. Ibrahim Rugova, në kujtesën e popullit të Kosovës dhe kombit shqiptarë, por edhe tek të gjithë njerëzit liridashës, do të mbetet një nga udhëheqësit më karizmatik dhe i dashur për popullin e vet, sepse këtë ia mundësuan mençuria, urtësia dhe dashuria që kishte për popullin e tij, veti të e bëjnë atë simbolin e lirisë së popullit dhe pavarësisë së Kosovës.

Në kuadër të delegacioneve që kanë ardhur në Kosovë për t'i bërë nderime Presidentit Rugova ishte edhe Delegacioni i kryetarëve të Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, kryesuar nga z.Ferdinand Pone, u.d ministër i Pushtetit Lokal. Me këtë rast, përfaqësuesit e pushtetit lokal të Shqipërisë kanë bërë homazhe pranë trupit të pajetë të Presidentit të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova dhe kanë marrë pjesë në ceremoninë e varrimit. Poashtu kryetarët e Bashkitë e Shqipërisë dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë janë takuar edhe me kryetarin e AKK-së z.Ismet Beqiri ku i kanë shprehur ngushëllimet e Bashkive të Shqipërisë për AKK-në dhe kryetarët e Komunave të Kosovës.